



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E GJILANIT  
MUNICIPALITY OF GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

# Raport mbi vlerësimin e ndikimit të pandemisë COVID 19 në ekonominë lokale në Komunën e Gjilanit



Korrik 2020

Gjilan

# PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive.....	7
Metodologjia e hulumtimit .....	9
Të gjeturat e hulumtimit .....	9
Lokacioni i bizneseve .....	10
Lloji i bizneseve .....	10
Veprimtaria e bizneseve.....	10
Qarkullimi vjetor për vitin 2019.....	11
Numri i punëtorve para dhe gjatë pandemisë.....	12
Niveli i shitjës gjatë pandemisë.....	12
Mungesa e stafit si rezultat i izolimit.....	13
Zvogëlimi i kërkesave nga klientët si rezultat i pandemisë.....	14
Mungesa e likuiditetit si rezultat i pandemisë.....	15
Mungesa e furnizimeve si rezultat i pandemisë.....	15
Shkëputja e kontratave si rezultat i pandemisë.....	16
Periudha maksimale që bizneset operojnë pa humbje.....	17
Periudha maksimale që të mos largohet ndonjë punëtorë nga puna.....	17
Reduktimi i punëtorve gjatë tre muajve të ardhshëm.....	18
Vazhdimi i veprimtarisë në të ardhmën.....	19
Funksionimi aktual i bizneseve.....	19
Humbjet gjatë periudhës së pandemisë për bizneset sipas veprimtarive.....	20
Pakoja emergjente e Qeverisë së Republikës së Kosovës.....	20
Konkluzione dhe rekomandime.....	21
Programi i Komunës së Gjilanit.....	22
Covid 19 Plani i rikuperimit ekonomik lokal.....	23
Shtojca 1- Vendimi i Kryetarit.....	26

## Lista e figurave

Figura 1: Lokacioni i Bizneseve.....	9
Figura 2: Lloji i bizneseve.....	10
Figura 3: Veprimtaria e bizneseve.....	11
Figura 4: Qarkullimi vjetor për vitin 2019.....	11
Figura 5: Numri i punëtorëve para dhe gjatë pandemisë.....	12
Figura 6: Niveli i shitjes gjatë pandemisë.....	13
Figura 7: Mungesa e stafit si rezultat i izolimit.....	14
Figura 8: Zvogëlimi i kërkesave nga klientët si rezultat i pandemisë.....	14
Figura 9: Mungesa e likuiditetit si rezultat i pandemisë.....	15
Figura 10: Mungesa e furnizimeve si rezultat i pandemisë.....	16
Figura 11: Shkëputja e kontratave si rezultat i pandemisë.....	16
Figura 12: Periudha maksimale që bizneset mperojnë pa humbje.....	17
Figura 13: Periudha maksimale që të mos largohet ndonjë punëtorë nga puna.....	18
Figura 14: Reduktimi i punëtorve gjatë tre muajve të ardhshëm.....	18
Figura 15: Vazhdimi i veprimtarisë në të ardhmën.....	19
Figura 16: Funkionimi aktual i bizneseve.....	19
Figura 17: Humbjet gjatë periudhës së pandemisë për bizneset sipas veprimtarive...20	
Figura 18: Pakoja emergjente e Qeverisë së Republikës së Kosovës.....	21

Pandemia e virusit korona, përveç rreziqeve që po paraqet për shëndetin e qytetarëve tanë, ka shkaktuar pasoja të pallogaritshme si në ekonominë globale, ashtu edhe në ekonominë e Kosovës. COVID-19 ka paralizuar sektorët me jetik të ekonomisë si: transportin, ndërtimin, shërbimet në fushën e hotelerisë dhe gastronomisë si dhe prodhimin e që në masë të madhe janë kontribuesit kyç në zhvillim ekonomik lokal. Kosova ashtu sikurse shumë vende të tjera të botës u prek nga pandemia dhe kjo do ketë efekte negative në ekonomi.

Me qëllim të vlerësimit të ndikimit të pandemisë COVID 19 në ekonominë lokale, kryetari i Komunës së Gjilanit z. Lutfi Haziri ka themeluar një ekip ndër institucional në nivel të komunës përbërë nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra Rajonale e Punësimit, Agjencia për Zhvillim Rajonal Lindje dhe Oda Ekonomike e Kosovës dega në Gjilan për të realizuar një hulumtim me bizneset që zhvillojnë aktivitetet e tyre afariste në territorin e komunës dhe funksionimi i të cilave është penguar ose rrezikuar nga masat për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 të Ministrisë së Shëndetësisë në periudhën prej 13 Mars deri me 31 Maj 2020.

Marrë parasysh rëndësinë e sektorëve më të ndikuar si hoteleria, gastronomia, transporti, ndërtimtaria dhe në masë të madhe edhe prodhimi, bujqësia si dhe shërbimet për ekonominë e Komunës së Gjilanit, shqetësimin e komunitetit të biznesit të këtyre sektorëve, gjendjen socio-ekonomike të krijuar pas shpërthimit të pandemisë COVID-19, ekipi ka zhvilluar një hulumtim online me biznese për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e virusit COVID-19 në ekonominë lokale si dhe efektet pas pandemisë përfshirë propozimin e masave të nevojshme që duhet të ndëmerren për rikuperim të ekonomisë dhe tejkalimin e situatës.

# Hyrje

Më 13 Mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë masa me qëllim të parandalojnë përhapjen e pandemisë së virusit COVID-19 në vend dhe ruajtjen e shëndetit të qytetarëve. Masat e ndërmarra kufizuan lëvizjen e qytetarëve, ndërprerjen e procesit mësimor në shkolla dhe universitete, ndërprerjen e pjesës dërmuese të aktiviteteve të bizneseve përfshirë mbylljen e plotë të disa prej tyre. Këto masa gjithashtu kanë ndikuar edhe në sektorin publik pasi janë kufizuar mundësitë për realizimin e investimeve kapitale publike.

Pandemia COVID-19 ka bërë të sotmen dhe të ardhmen të pasigurtë dhe të paparashikueshme jo vetëm në Kosovë por në nivel global. Kujdesi ndaj shëndetit është një detyrë dhe përgjegjësi shumë e rëndësishme që i takon të gjithëve si niveli qendror ashtu edhe atij lokalë me ç'rast Komuna e Gjilanit ka luajtur një rol aktiv në menaxhimin, kontrollin e shpërthimit të virusit dhe parandalimin e saj, si dhe është duke vazhduar përpjekjet për të gjetur mënyra për të ndihmuar edhe në tejkalimin e krizës dhe rikuperimin e ekonomisë.

Humbjet llogariten të jenë të konsiderueshme për sektorët e ekonomisë si gastronomia, hoteleria, transporti, ndërtimtaria etj. I vetmi sektor që deri diku ka mundur të minimizoj humbjet është tregtia e produkteve elementare ushqimore dhe higjienike.

Bazuar në të dhënat që posedon Qendra për Regjistrimin e Bizneseve (QRB) në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Komuna e Gjilanit në fund të vitit 2019 kishte të regjistruara 4,024 biznese, prej tyre mbi 3,000 biznese aktive dhe veprimtaritë kryesore janë tregtia me 54 %, shërbimi me 29%, prodhimi me 11% dhe ndërtimtaria

me 6% derisa kanë të punësuar mbi 9,000 punëtorë. Vlen të përmendet se gjatë periudhës 01 Janar- 31 Maj 2020 në Qendrën për Regjistrimin e Biznesit, gjithësej 90 biznese të reja janë regjistruar që kanë punësuar 141 punëtorë ndërsa janë ç’regjistruar 10 biznese dhe 12 punëtorë. Këto të dhëna flasin për rëndësinë e sektorëve në ekonominë e Komunës së Gjilanit.

Këtij hulumtimi i janë përgjigjur 304 biznese. Mënyra e grumbullimit të dhënave është bërë përmes platformës online. Shpërndarja e pyetësorit është bërë përmes rrjeteve sociale, email-ave si dhe anketimit direkt me përfaqësues të bizneseve me qëllim të vlerësimit të ndikimit të virusit COVID-19 në ekonominë lokale.

Për të zbutur pasojat negative në ekonomi, punonjës dhe qytetarë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarr një seri masash mbështetëse dhe ndihmëse përmes Pakos Emergjente Fiskale për ekonominë dhe qytetarët, dhe një pjesë e konsiderueshme e barrës për të ndihmuar ekonominë të rimëkëmbet po synohet edhe nga komuna e Gjilanit. Me qëllim që ndihma e komunës së Gjilanit të koordinohet dhe të jetë me kohë, komuna ka ndërmarrë një program masash lehtësuese për të mbështetur bizneset që kryejnë aktivitetet e tyre afariste në territorin e komunës dhe funksionimet e të cilave janë penguar ose rrezikuar nga masat e Ministrise se Shendetesise. Programi me masa lehtësuese për biznese është prezantuar në kapitullin e mëposhtëm të këtij raporti “Konkludime dhe rekomandime”.

Komuna e Gjilanit në përputhje me legjislacionin në fuqi, prioritetet dhe nevojat specifike të saj, ka krijuar masa lehtësuese që do të japin rezultatin më të mirë për rikuperimin e ekonomisë lokale dhe do të ndikojnë në ruajtjen e standardit të qytetarëve pa kompromentuar qëndrueshmërinë e financave publike si dhe kryerjen e funksioneve themelore në kompetencë të komunës.

## Përmbledhje ekzekutive

Hulumtimi me biznese është realizuar gjatë muajit Maj 2020. Këtij hulumtimi i janë përgjigjur 304 biznese të Komunës së Gjilanit dhe ky raport prezanton gjetjet e bazuara nga përgjigjet e pranura nga biznese të sektorëve të ndryshëm si: prodhuese, shërbyese, tregtare, ndërtimore, transportuese, artizanale, zejtare etj. Shpërndarja e pyetësorit është bërë përmes rrjeteve sociale, email-ave si dhe anketimit direkt me përfaqësues të bizneseve me qëllim të vlerësimit të ndikimit të virusit COVID-19 në ekonominë lokale.

Komuna ka krijuar masa lehtësuese që do të japin rezultatin më të mirë për rikuperimin e ekonomisë lokale dhe do të ndikojnë në ruajtjen e standardit të qytetarëve pa kompromentuar qëndrueshmërinë e financave publike si dhe kryerjen e funksioneve themelore në kompetencë të komunës. Programi me masa lehtësuese është prezantuar në kapitullin e fundit të këtij raporti “Konkluzione dhe Rekomandime”.

Hulumtimi gjenë se:

- Gjatë periudhës 01 Janar- 31 Maj 2020 në Qendrën për Regjistrimin e Biznesit, gjithësej **90 biznese të reja** janë regjistruar që kanë punësuar **141 punëtorë** ndërsa janë ç’regjistruar 10 biznese dhe 12 punëtorë.
- **69% të bizneseve** pjesëmarrëse në hulumtim zhvillojnë afarizëm në qytet, 27% në fshatra dhe 4% prej tyre kanë degë të tyre jashtë territorit të Komunës. Hulumtimi është realizuar me **304 biznese** të komunës së Gjilanit, prej tyre **42 % biznese individuale**, **38 %** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, **19 %** fermerë ndërsa **1 %** shoqëri aksionare.

- Pandemia ka ndikuar në **humbjen e 788 vendeve të punës**. Për gati gjysmën e bizneseve të anketuara **(46%) mungesa e punëtorëve** për shkak të izolimit ka pasur **ndikim të lartë në afarizimin** e tyre. Shumica dërmuese e bizneseve **(80%) kanë deklaruar** se pandemia ka ndikuar **në rënien e kërkesës për shërbime/produkte. 66 % të bizneseve** kanë shënuar **mungesë të likuiditet**. Derisa **48%** kanë deklaruar për **pengesa në furnizime** gjatë pandemisë.
- Hulumtimi gjenë se pandemia **rrezikon** më së shumti **bizneset e vogla**. Vetëm **8% e bizneseve** mendojnë se mund **të përballojnë** situatën e pandemisë. Rreziku i largimit të punëtorëve nga puna është i lartë. Shpresëdhënëse është fakti se vetëm **50% e bizneseve** nuk do të **pushojnë punëtorët** nga puna.
- **46% e bizneseve** kanë deklaruar **rënie të nivelit të shitjes prej 90-100%**, dhe vetëm **1% e bizneseve** të anketuara kanë deklaruar se **niveli i shitjes** ka qenë i **njejtë**.
- Më shumë se gjysma e bizneseve **(56%) mbajnë një perspektivë optimiste për të ardhmen e biznesit**.
- Shumica e bizneseve kanë deklaruar **humbje të konsiderueshme** dhe prin prodhimi, tregtia, shërbimet, hoteliere, pasuar nga ato ndërtimore, bujqësore, transportuese derisa më së paku humbje kanë deklaruar bizneset shëndetësore dhe edukativo-arsimore.
- **60% e bizneseve** të anketuara kanë deklaruar se **nuk kanë pranuar mbështetje** nga kjo pakoja emergjente fiskale e qeverisë së Republikës së Kosovës.



# Metodologjia e Hulumtimit

Pyetësi është dizajnuar nga Ekipi punues në bashkëpunim me institucionet relevante për mbledhjen e të dhënave të përgjithshme për bizneset e Komunës së Gjilanit. Hulumtimi prezanton gjetjet e bazuara nga përgjigjet e pranuar nga 304 biznese të sektorëve të ndryshëm si: prodhuese, shërbyese, tregtare, ndërtimore, transportuese, artizanale, zejtare etj.


Pyetësi është bërë publik në webfaqe dhe facebook të Komunës së Gjilant, rrjete sociale (online), është dërguar përmes email-ave si dhe anketimit direkt në terren.

## Të gjeturat e hulumtimit

### Lokacioni i bizneseve

Hulumtimi është realizuar me bizneset të cilat ushtrojnë veprimtarinë në Komunën e Gjilanit, prej tyre 69% zhvillojnë afarizëm në qytet, 27% në fshatra dhe 4% kanë degë të tyre jashtë territorit të Komunës.


*Figura 1: Lokacioni i Bizneseve*



## Lloji i bizneseve

Hulumtimi është realizuar me 304 biznese të komunës së Gjilanit, prej tyre 42 % biznese individuale, 38 %, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, 19 % fermerë ndërsa 1 % shoqëri aksionare.


Figura 2: Lloji i bizneseve



## Veprimtaria e bizneseve

Veprimtaritë biznesore që i janë përgjigjur hulumtimit janë me sa vijon: sektori i shërbimeve me 31%, tregti dhe biznese bujqësore me 19% , bizneset prodhuese me 13% , hoteliere 8%, transportuese 4%, ndërtimore 3%, shëndetësore 2% dhe edukativo-arsimore me 1%.


Figura 3: Veprimtaria e bizneseve



## Qarkullimi vjetor për vitin 2019


Hulumtimi nxjerr në pah se 27% e bizneseve të anketuara kane pasur 1,000 - 5,000€ qarkullim vjetor gjate vitit 2019, 22% e bizneseve 5,000 -10,000 10% e bizneseve 10,000-20,000€, 2% e bizneseve 20, 000-30,000 Euro, 2% e bizneseve 30,000-40,000 Euro, 3% e bizneseve 40,000-50,000 Euro, 14% e bizneseve 50,000-300,000 Euro, 7% e bizneseve 300,000-700,000 Euro, 1% e bizneseve 700,000 – 1mil. Euro dhe 2% e bizneseve mbi 4 mil Euro.

Figura 4: Qarkullimi vjetor për vitin 2019



## Numri i punëtorëve para dhe gjatë pandemisë

Figura 5: Numri i punëtorëve para dhe gjatë pandemisë




Hulumtimi me bizneset e anketuara tregon se në masë të madhe është reduktuar numri i punëtorëve prej 3,409 sa ishin para pandemisë në 2,621 gjatë pandemisë duke ndikuar në humbje të 788 vendeve të punës. Pra, kemi një rënie prej 23% të numrit të gjithëmbarshëm të punëtorëve tek kompanitë e anketuara. Kryesisht bizneset e mëdha dhe të mesme kanë zvogëluar në masë të madhe numrin e punëtorëve gjatë pandemisë dhe pothuaj e njejta situatë është deklaruar edhe nga bizneset e vogla përderisa bizneset individuale (me një punëtor ose të vet-punësuar) kanë shënuar rritje gjatë kohës së pandemisë (54 punëtorë para pandemisë ndërsa 64 punëtorë gjatë pandemisë).

## Niveli i shitjes gjatë pandemisë

Të gjeturat e hulumtimit tregojnë se vetëm 1% e bizneseve të anketuara kanë deklaruar se niveli i shitjes ka qenë i njëjtë 1% e bizneseve kanë deklaruar rënie per 10% të nivelit të shitjes, 2% e tyre kanë deklaruar se ka rënie të nivelit të shitjes prej 10%-20%, 2% e bizneseve kanë deklaruar se kanë pësuar rënie të shitjes prej 20-30%, 6% e bizneseve kanë deklaruar rënie prej 30-40%, ndërsa 14% e bizneseve kanë deklaruar rënie të shitjes 40-50%, 11% e bizneseve kane deklaruar se kane pesuar renie prej 50- 60%, 4% e bizneseve prej 60-70%, 6% e bizneseve 70-80%, 7% e bizneseve 80-90% dhe 46% e bizneseve kane deklaruar rënie te shitjes prej 90-100%.


Figura 6: Niveli i shitjes gjatë pandemisë



## Mungesa e stafit si rezultat i izolimit

46% e bizneseve kanë deklaruar se mungesa e punëtorëve për shkak të izolimit ka pasur ndikim të lartë, 34% e tyre kanë deklaruar se ka patur ndikim të ulët, 12% e bizneseve kanë deklaruar se ka pasur ndikim të mesëm dhe 8% e bizneseve nuk janë deklaruar për ndikimin e mungesës së punëtorëve gjatë panedmisë.

Figura 7: Mungesa e stafit si rezultat i izolimit




## Zvogëlimi i kërkesave nga klientët si rezultat i pandemisë

Përqindja më e madhe apo 80% e bizneseve të anketuara deklarojnë se rënia e

kërkesave nga klientët për shkak të pandemisë ka patur ndikim të lartë, derisa 15% e bizneseve kanë deklaruar se zvogëlimi i kërkesave nga klientët për produktet dhe shërbimet e bizneseve të tyre ka pasur ndikim të mesëm dhe 2% e bizneseve kanë deklaruar ndikim të ulët.


Figura 8: Zvogëlimi i kërkesave nga klientët si rezultat i pandemisë



## Mungesa e likuiditetit si rezultat i pandemisë

Shumica e bizneseve apo 66% kanë deklaruar se mungesa e likuiditetit si rezultat i pandemisë ka patur ndikim të lartë, 26 % kanë deklaruar se mungesa e likuiditetit ka patur ndikim të ulët, ndërsa pjesa tjetër (7%) kanë deklaruar se mungesa e likuiditetit ka pasur ndikim të mesëm në afarizmin e tyre.


Figura 9: Mungesa e likuiditetit si rezultat i pandemisë



## Mungesa e furnizimeve si rezultat i pandemisë

Hulumtimi tregon se 48% e bizneseve kanë deklaruar se mungesa e furnizimeve si rezultat i pandemisë ka patur ndikim të madh, 8% kanë deklaruar se ka patur ndikim të mesëm, 31% e bizneseve kanë deklaruar se ndikimi ka qenë i ulët dhe 13% e bizneseve janë pergjigjur “nuk e di”.


Figura 10: Mungesa e furnizimeve si rezultat i pandemisë



## Shkëputje e kontratave si rezultat i pandemisë

Prej bizneseve respodente 47% kanë deklaruar se shkëputja e kontratave për shkak të situatës me pandeminë ka patur ndikim të lartë në afarizëm, 20% kanë deklaruar ndikim të mesëm ndërsa 19% të bizneseve kanë deklaruar për ndikim të ulët ndërsa 14% të bizneseve janë pergjigjur “nuk e di”.

Figura 11: Shkëputje e kontratave si rezultat i pandemisë






## Periudha maksimale që biznesi të operojë pa humbje

Një përqindje e madhe 54% e bizneseve deklarojnë se nuk mund ta përballojnë situatën me pandemi dhe periudha maksimale që biznesi mund të operojë me rezultat pozitiv ose pa humbje është 0-3 muaj, 30% e bizneseve mund të mbijetojnë deri në 6 muaj ndërsa 8% e bizneseve mund të operojnë prej 3-6 dhe 9-12 muaj.


Figura 12: Periudha maksimale që biznesi të operojë pa humbje



## Periudha maksimale të mos largohet ndonjë punëtor nga puna

Sa i përket largimit të punëtorëve për shkak të rezultateve negative që ka shkaktuar pandemia tek bizneset, 26% e bizneseve kanë deklaruar se mund ti mbajnë punëtorët deri në 2 muaj, 24% e bizneseve kanë deklaruar se mund ti mbajnë punëtorët për një periudhë prej maksimum deri 1 muaj ndërsa 50% e bizneseve të anketuara kanë deklaruar se nuk planifikojnë largimin e punëtorëve nga puna.


Figura 13: Periudha maksimale të mos largohet ndonjë punëtor nga puna



## Reduktimi i punëtorëve gjatë tre muajve të ardhshëm

Në pyetjen se sa do të jetë numri i punëtorëve që bizneset planifikojnë të reduktojnë gjatë tre muajve të ardhshëm (Qershor-Gusht), 70% e bizneseve nuk planifikojnë të reduktojnë fare numrin e punëtorëve, 17% e bizneseve do të largojnë 1-3 punëtorë, 9% e bizneseve kanë deklaruar se do të zvogelojnë numrin prej 4-10 punëtorëve, 2% e bizneseve kanë deklaruar se do të reduktojnë prej 11-20 punëtorëve, 1% do të largojnë mbi 30 punëtorë ndërsa 1% e bizneseve janë deklaruar se do ta zvogelojnë numrin prej 21-30 punëtorëve.


Figura 14: Reduktimi i punëtorëve gjatë tre muajve të ardhshëm



## Vazhdimi i veprimtarisë në të ardhmen

Në pyetjen se a do të jenë në gjendje biznesi të vazhdojë afarizimin edhe në të ardhmen 56% e bizneseve kanë deklaruar se do të mbijetojnë, 2% janë deklaruar se nuk do të mund të mbijetojnë derisa 42% e bizneseve janë përgjigjur “nuk e di”.


Figura 15: Vazhdimi i veprimtarisë në të ardhmen



## Funksionimi aktual i bizneseve


Hulumtimi është realizuar gjatë muajit Maj 2020 kështuqë pyetja e parashtruar bizneseve se a është duke funksionuar aktualisht biznesi i tyre, 60% e bizneseve janë përgjigjur pozitivisht derisa 40% e bizneseve janë deklaruar se kanë ndërprerë veprimtarinë.

Figura 16: Funksionimi aktual i bizneseve



## Humbjet gjatë periudhës së pandemisë për bizneset sipas veprimtarive

Figura 17: Humbjet gjatë periudhës së pandemisë për bizneset sipas veprimtarive




Shumica e bizneseve kanë deklaruar humbje të konsiderueshme dhe prin prodhimi, tregtia, shërbimet, hoteliere, pasuar nga ato ndërtimore, bujqësore, transportuese derisa më së paku humbje kanë deklaruar bizneset shëndetësore dhe edukativo-arsimore.

## Pakoja emergjente e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Në pyetjen se a kanë përfituar bizneset nga Pakoja Emergjente Fiskale e Qeverisë së Republikës së Kosovës, 60% e bizneseve të anketuara të Komunës së Gjilanit janë deklaruar se nuk kanë pranuar mbështetje nga kjo pako, ndërsa 40% e bizneseve kanë deklaruar se kanë përfituar nga pakoja fiskale emergjente.

Figura 18: Pakoja emergjente e Qeverisë së Republikës së Kosovës



## Konkluzione dhe Rekomandime

Bazuar në të gjeturat nga ky hulumtim, dhe me qëllim të rikuperimit ekonomik konkludojmë:

- Pakoja Fiskale Emergjente e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës mund të ndikoj në afat të shkurtër në tejkalimin e situatës mirëpo nuk mjafton për të kthyer ekonominë në binarë në aspektin afat gjatë;
- Pakoja për rimëkëmbjen e ekonomisë duhet të implementohet me kohë pasi çdo vonesë eventuale në zbatim do të ketë domino efekt negativ më vonë;
- Investimet publike në periudhën afat-mesme të orientohen në projekte – infrastrukturë e butë me ndikim në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës;
- Të krijohen lehtësira për biznese të cilat kanë plane për zgjerim të kapaciteteve dhe krijim të vendeve të reja të punës;



Në bazë të vendimit të kryetarit të komunës Nr.02/321, të datës 18.03.2020 mbi themelimin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe në bazë të kompetencave që dalin njxerr:

### PAKON E MASAVE TË NDËRRMARA NË FUNKSION TË MENAXHIMIT TË SITUATËS PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19

1. Lirimi nga taksa komunale për ushtrimin e veprimtarive afariste të gjitha bizneset që operojnë në territorin e komunës së Gjilanit vetëm për vitin 2020, përjashtimisht borxheve nga vitet paraprake;
2. Lirimi nga pagesa e tarifave për përdorimin e parkingjeve, të cilave u është dhënë në shfrytëzim nga komuna për një periudhë 6 muaj, d.m.th., për ata të cilët nuk ushtrojnë veprimtarinë me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë;
3. Lirimi nga pagesa me qira për një periudhë prej 12 muajsh qiramarrësit e lokaleve afariste në pronësi të komunës përfshirë edhe kafeteritë (që shfrytëzojnë terracat) të cilat nuk kanë kryer veprimtarinë e tyre të rregullt me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë;
4. Lirimi nga qiraja për gjashtë muaj rresht vetëm familjeve që banojnë në objekte në pronësi të komunës.
5. Lirimi për një periudhë prej 12 muajsh qiramarrësit e tezgave (bujqit) të tregjeve mobile për shitjen e produkteve bujqësore;
6. Sigurimi i tezgave për Tregjet mobile dhe hapësirave në: (Velekincë, Arbëri, Bojaninë, Stacioni i Autobusave, Dardania II, Rruga e Prishtinës-Ish market Pireva, Rr.Marie Shllaku-Ish restorant Lura).
7. Subvencionimi me farë misri dhe plehra artificiale për bujqit.
8. Të shtyhet pagesa e tarifave për legalizimin e objekteve të paligjshme për një periudhë 3 muaj për tatimpaguesit që kanë lidhur kontrata, me dinamikë pagese në këste (sipas kërkesës). Interesi për borxhet nuk do të ngarkohet për periudhën e caktuar;
9. Të gjithë kontraktuesve (operatoreve ekonomik) të cilët nuk kanë qenë në gjendje të kryejnë punën brenda afatit të rënë dakord, për shkak të mungesës së materialeve dhe fuqisë punëtore, do t'u zgjatet data e përfundimit, d.m.th. të hartohet një aneks kontratë për dy muaj shtesë, në mënyrë që të shmanget pagesa e gjobave për mos përmbushje të detyrimeve të përcaktuara me kontratë.
10. Sigurimi i 400 pakove që përfshijnë mjete higjienike të dedikuara për familjet në nevojë me asistencë sociale.

11. Sigurimi i seteve mbrojtëse për marrjen e mostrave të Covid-19.
12. Pastrimi dhe Dezinfektimi i Hapësirave Publike, kryesisht në rrugët e qytetit.
13. Mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e luleve sezonale si dhe drunjë dekorativ në vendet e caktuara.
14. Lirimi i të gjitha hapësirave publike, shiritimi i të gjitha paraqeve të qytetit dhe objekteve tjera komunale të cilat kanë shërbyer për rekreacion dhe të cilat kanë mundur të jenë burim i mundshëm për përhapjen e virusit Covid-19 si dhe kontrole të përditshme në biznese të ndryshme.
15. Ky vendim hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim.

20 prill 2020  
Gjilan



Shef Ekzekutiv i Komitetit

Lutfi Haziri

## COVID-19 Plani i Rikuperimit Ekonomik lokal

Pandemia Covid-19 ka bërë të sotmen dhe të ardhmen të pasigurtë dhe të paparashikueshme jo vetëm në Kosovë por në nivel global. E ardhmja e ekonomisë në përgjithësi varet nga situata epidemiologjike që sipas ekspertëve shëndetësor ende ekziston rrezik nga përhapja si dhe sipas tyre pritet të rikthehet prap në vjeshtë. Për të tejkaluar këtë situatë nevojitet bashkëpunim dhe bashkërendim i veprimeve ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror si dhe bashkëpunim me qytetarë dhe biznese. Komuna e Gjilanit si dhe komuniteti i biznesit duhet të përshtaten me situatën e re të krijuar duke ndërmarrë veprimet si në vijim:

- Të adaptojnë veprimtaritë e tyre për të siguruar pajisje të nevojshme mbrojtëse personale për punëtorë.
- Të përshtaten me mënyrën për të ofruar produktet dhe shërbimet e tyre.
- Të orientohen drejt digjitalizimit të bizneseve duke shfrytëzuar platformën online për t'iu përshtatur rrethanave dhe kërkesave aktuale.

Ky plan ka për qëllim të identifikoj nevojat dhe sfidat e bizneseve si dhe mundësitë për bizneset në periudhën afat-shkurtër. Identifikimi i bizneseve me rrezik të lartë dhe i mënyrave për përkrahje gjatë dhe pas pandemisë është jetik për mbrojtje të punëtorëve dhe bizneseve. Synimi parësor është të mbështeten bizneset gjatë gjithë kësaj periudhe në mënyrë që ato të mund të vazhdojnë veprimtaritë dhe kthimin në normalitet duke u kujdesur edhe për ruajtjen e vendeve ekzistuese të punës, dhe potencialisht për të siguruar rritje ekonomike në të ardhmen.



Veprimi 1	Krijimi i një adrese elektronike në kuadër të DZHE/ QRB për komunikim të rregullt me biznese për të parashtruar kërkesat e tyre.
Veprimi 2	Qasje proaktive për të gjitha bizneset dhe sektorët –identifikimi i në vazhdimësi i sfidave dhe mundësive.
Veprimi 3	Inkurajimi i bizneseve për pjesëmarrje në debate/dëgjime publike për mundësitë për investime.
Veprimi 4	Bashkëpunimi me media lokale dhe organizimi i takimeve për të informuar bizneset për mundësitë për grante, subvencione të bizneseve, punëtorëve dhe forma tjera të mbështetjes sektorit privat nga niveli qendror dhe donator ndërkombëtar.
Veprimi 5	Ofrimi i këshillave/asistencës teknike bizneseve për aplikim në Pakon për Rimëkëmbje Ekonomike të Qeverisë së Republikës së Kosovës
Veprimi 6	Ofrimi i asistencës teknike bizneseve për aplikim në thirrje të ndryshme nga burime potenciale të financimit.
Veprimi 7	Identifikimi i donatorëve potencial për mundësinë për mbështetje bizneseve të vogla përmes skemave të granteve, trajnimeve në ndërmarrësi etj.
Veprimi 8	Komunikimi i rregullt me nivelin qendror për krijimin e lehtësirave për bizneset e rrezikuara edhe pas pandemisë
Veprimi 9	Funksionalizimi i Inkubatorit të Biznesit -TIK

## Ekipi i angazhuar për realizimin e hulumtimit

Valbona Tahiri, Drejtoreshë, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Komuna e Gjilanit

Email: [valbona.tahiri@rks-gov.net](mailto:valbona.tahiri@rks-gov.net)

Ramiz Ramadani, Drejtor, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Gjilanit

Email: [ramiz.ramadani@rks-gov.net](mailto:ramiz.ramadani@rks-gov.net)

Bekim Bajrami, Drejtor, Drejtoria për Urbanizëm, Mbrojtje të Mjedisit dhe Planifikim, Komuna e Gjilanit

Email: [bekim.bajrami@rks-gov.net](mailto:bekim.bajrami@rks-gov.net)

Agim Zeka, Drejtor, Agjencia për Zhvillim Rajonal (AZhR) Lindje

Email: [agim.zeka@ardaeast.eu](mailto:agim.zeka@ardaeast.eu)

Xhevat Aliu, Drejtor, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale /Zyra Rajonale e Punësimit

Email: [xhevat.aliu@rks-gov.net](mailto:xhevat.aliu@rks-gov.net)

Ibrahim Tahiri, Oda Ekonomike e Kosovës, dega në Gjilan

Email: [ibrahim.tahiri@hotmail.com](mailto:ibrahim.tahiri@hotmail.com)

Falenderojmë të gjitha bizneset që morën pjesë në këtë hulumtim për ndikimin e pandemisë Covid-19 në komunitetin e biznesit dhe afarizmin e tyre. Vlerësojmë pjesëmarrjen, kohën tuaj për të ju përgjigjur pyetësorit si dhe kontributin tuaj në këtë hulumtim të rëndësishëm për të kuptuar efektet e pandemisë Covid -19 në ekonominë e Gjilanit.

Shpresojmë që bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe komunitetit të biznesit do të thellohet edhe më tej në të ardhmen.

# Shtojcë 1. Vendimi i Kryetarit



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjilanit merr këtë:

## V E N D I M

1. Me këtë vendim formohet Ekipi për vlerësim të ndikimit të Covid 19 në ekonomi në Komunën e Gjilanit, në këtë përbërje:
  - 1.1. Valbona Tahiri, kryesuese
  - 1.2. Ramiz Ramadani, anëtar
  - 1.3. Bekim Bajrami, anëtar
  - 1.4. Agim Zeka, AZHR Lindje, anëtar
  - 1.5. Xhevat Aliu, QRP, anëtar
  - 1.6. Ibrahim Tahiri, OEK, anëtar
2. Ekipi i vlerësimit në përbërje të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, do të punojë në vlerësimin e gjendjes aktuale të ekonomisë në Gjilan si dhe zhvillimin e një plani të rimëkëmbjes së saj.
3. Ekipi i vlerësimit për punën e tij do t'i raportojë Kryetarit të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Ekipit vlerësues
- Arkivit



Kryetar i Komunës  
Lutfi Hazifi